



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

(Specialist Auditi)

Lloji i diplomës “ Bachelor në Financë Ekonomik Juridik”

Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit Master Profesional”

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicionëve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Mallakastër**, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm, kategoria: IV-A

Afati për dorëzimin e dokumentave për

04.05.2022

LEVIZJE PARALELE:

Afati për dorëzimin e dokumentave për

09.05.2022

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:

Përshkrim i Përgjithshëm.

Dhënia në mënyrë të pavarur e sigurisë objektive dhe këshillimit për drejtimin, për të vlerësuar dhe për të përmirësuar veprimet, frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësive publike. Auditimi i brendshëm", është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e vet, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësive publike. Në këtë funksion përfshihen

DETYRAT

Detyrat Kryesore

1. Mbështetja e njësive publike për të arritur qëllimet e saj, duke:
 - b. ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike;
 - c. vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave e kontroleve;
 - d. mbështetja e njësive publike në menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:
 - i. identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësive publike;
 - ii. përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;
 - iii. besueshmërinë dhe gjithë-përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional.
 - f. kryerjen e veprimtarive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;
 - g. ruajtjen e aseteve dhe të informacionit;
 - h. përmirësimin e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
 - i. dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike.
 - j. mbështetja e angazhimeve/kryerja e detyrave të veçanta të auditimit për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;
 - k. dhënia e vlerësimeve objektive, opinioneve ose përfundimeve të pavarura për një proces, sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.
 - l. në konsultim paraprak me Kryetarin e Bashkisë, dhe me miratimin e tij, harton programin vjetor të auditimeve dhe, në përputhje me të, planin mujor;
 - ll. siguron që në keto programe, auditimet do të jenë të mjaftueshme për të siguruar shqyrtim efektiv dhe të rregullt të të gjitha operacioneve mbi një cikël të planifikuar;
 - m. vlerëson raportin e kontrollit (vlerësim teknik), të hartuar nga grupi i kontrollit së bashku me të gjithë elementët e tjerë të dosjes së kontrollit dhe ia paraqet për miratim Kryetarit të Bashkisë;
 - n. realizon vlerësime, inspektime, investigime, ekzaminime apo shqyrtime, që mund të kerkohen nga Kryetari i Bashkisë;
 - nj. realizon vlerësimin teknik për raportet e kontroleve të jashtme që i bëhen Bashkisë dhe ia paraqet Kryetarit të Bashkisë.
- Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1. LËVIZJA PARALELE

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori; ;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

-Për pozicionin Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm, kategoria: IV-A

1. Diplomë bachelor në financë, ekonomik,juridik.
2. Master profesional në financë, ekonomik,juridik.
3. Të ketë të paktën 1 vit pune në administratën publike.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë**, në zyrën e **Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).
10. Vërtetim te gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore.(Dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor).

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës **04.05.2022**.*

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **05.05.2022**, **Njësia** e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar të Punësimit", në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë në stendën e informimit të publikut., listën paraprake te kandidatëve që **do të vazhdojnë konkurimin** , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta** do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit

paraprak të kandidatëve në rrugë elektronike përmes e-mailit të paraqitur nga kandidati në dokumentacionin e aplikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji 10256 datë 8.7.2010 “Menaxhimi Financiar dhe kontrolli”(I ndryshuar);
2. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;
3. Udhëzimi 30/2011 i Ministrisë së Financave;
4. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
5. Ligjin nr.8399, date 9.9.1998 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.7776 date 22.12.1993 “Per Buxhetin lokal”,
6. Udhëzim i MF Nr. 17, datë 25.7.2011 për “Përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë”.
7. Udhëzimi i MF nr. 12, datë 05.06.2012 mbi “Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.\

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243 dt.18.03.2015

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- stendën e publikimeve të Bashkisë Mallakastër

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

-Për pozicionin *Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm*, kategoria: IV-a

1. Diplomë bachelor në financë, ekonomik, juridik.
2. Master profesional në financë, ekonomik, juridik.
3. Të ketë të paktën 1 vit pune në administratën publike.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë Kandidati duhet të dërgojë me postë në Zyrën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Mallakastër, këto dokumenta:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID); ;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;;
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

8. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë brenda datës 09.05.2022, në adresë të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Mallakastër.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **13.05.2022**, NJBNJ do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë Mallakastër dhe në standin e informimit të publikut, **listën paraprake të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin**, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë **kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive** dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për shkaket e moskualifikimit, në rrugë elektronike nëpërmjet emailit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore brenda 5 ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligji 10256 datë 8.7.2010 "Menaxhimi Financiar dhe kontrolli" (I ndryshuar);
2. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore;" ;
3. Udhëzimi 30/2011 i Ministrisë së Financave;
4. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
5. Ligjin nr.8399, datë 9.9.1998 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.7776 date 22.12.1993 "Per Buxhetin lokal",
6. Udhëzim i MF Nr. 17, datë 25.7.2011 për "Përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë".
7. Udhëzimi i MF nr. 12, datë 05.06.2012 mbi "Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit**, i ngritur pranë Bashkisë Mallakastër. Totali i pikeve të vlerësimit të kandidateve është 100 pike te cilat ndahen përkatësisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "*Specialist, Sektori i Auditit të Brendshëm*", kategoria **IV -A**

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive".

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brenda 24 (njëzet e katër) orëve, vendos në dispozicion listën e fituesve, Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

(Një pozicion) - Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm, kategoria: IV-A

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shpall listën e fitues.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"
- në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Mallakastër.

Kandidatët që nuk rezultojnë fitues kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në KPP për rezultatin e pikëve Brenda **5 ditëve kalendarike nga marra e njoftimit. Ankuesi merr përgjigje Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e ankesës.**

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : jllakaj@bashkiamallakaster.gov.al

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

BASHKIA MALLAKASTËR

LAURËTA SALIAJ

